RELACION TEKNIK

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Has

Relacion prezantues për miratimin e projektit: **"Hasi – Destinacion i Integruar Turistik Ndërkufitar: Model për Menaxhimin, Digjitalizimin dhe Zhvillimin e Turizmit Kulturor, Natyror dhe Rural", në kuadër të "Mekanizmit të Nxitjes së Kapaciteteve Bashkiake për Zbatimin e Projekteve" – Faza II, si dhe për miratimin e bashkëfinancimit të Bashkisë Has.**

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Bashkia Has paraqet për shqyrtim dhe miratim projektin "Hasi – Destinacion i Integruar Turistik Ndërkufitar: Model për Menaxhimin, Digjitalizimin dhe Zhvillimin e Turizmit Kulturor, Natyror dhe Rural". Projekt-propozimi është kualifikuar në Fazën I të thirrjes së Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe aktualisht po përgatitet paketa e plotë e Fazës II, për vijimin e procedurave drejt Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Marrëveshjes së Investimit.

Përputhshmëria strategjike. Projekti është konceptuar në përputhje me Programin Operacional 2024–2030 dhe me profilin funksional të Rajonit Natyral, ku përfshihet edhe Bashkia Has. Ky rajon përcaktohet si "Laborator i Zhvillimit Organik", ndërsa prioriteti strategjik lidhet me turizmin organik dhe rigjenerues: një model që aktivizon burimet natyrore, trashëgiminë kulturore, produktet lokale dhe jetën komunitare pa cenuar bazën mjedisore që i gjeneron ato. Në këtë logjikë, projekti synon ta kthejë potencialin endogjen të Hasit në një ofertë turistike të strukturuar, funksionale dhe të qëndrueshme.

Koncepti territorial dhe ndërhyrja e integruar. Kllasteri qe paraqet fshati i Letaj, propozohet si pol pilot i zhvillimit, ku ndërthuren trashëgimia historike e kulturore, peizazhi malor, Rezervuari i Letajt, etnografia, kulinaria dhe produktet karakteristike të Hasit. Ndërhyrja nuk trajtohet si një investim i izoluar, por si një zinxhir komponentësh komplementarë: aktivizimi i Muzeut "Kulla e Kurpalëve", qendra e pritjes dhe informacionit, zona rekreative pranë liqenit, shtigjet outdoor dhe pikat panoramike, si dhe digjitalizimi e promovimi i ofertës turistike. Të gjithë komponentët e financuar nga skema do të zhvillohen në territor dhe/ose asete të administruara nga Bashkia Has, sipas kërkesave të Udhëzuesit.

Qëllimi i projektit. Të krijojë një model të qëndrueshëm të menaxhimit të destinacionit, që lidh turizmin natyror, kulturor dhe rural me ekonominë lokale, duke e përdorur identitetin e Hasit dhe dimensionin e tij historik ndërkufitar si vlerë promovuese dhe si mundësi për zgjerimin e flukseve turistike.

Nëpërmjet projektit synohet: fuqizimi i kapaciteteve të Bashkisë Has për planifikim, prokurim, menaxhim, monitorim dhe promovim të një destinacioni të integruar; rritja e funksionalitetit të aseteve publike me potencial turistik; krijimi i sinergjisë mes natyrës, trashëgimisë dhe produkteve vendore; si dhe nxitja e një efekti përhapës në bujtina, agroturizëm, artizanat, bimë mjekësore, gastronomi dhe sipërmarrje të tjera lokale.

Komponentët kryesorë të ndërhyrjes

Qendra e pritjes, informimit dhe edukimit

Parashikohet krijimi i një Qendre të Pritjes dhe Informimit të Vizitorëve, si pikë funksionale për orientim territorial, informim, edukim dhe promovim të destinacionit. Arkitektura dhe zgjidhjet funksionale do të harmonizohen me peizazhin natyror dhe do të mbështesin menaxhimin e flukseve turistike, prezantimin e atraksioneve dhe lidhjen e vizitorit me ofertën kulturore, natyrore dhe rurale të territorit.



Zona rekreative pranë Rezervuarit të Letajt

Në zonën pranë Rezervuarit të Letajt parashikohet një ndërhyrje rekreative e kontrolluar, me mol të lehtë rekreativ, sistemim të hapësirës natyrore dhe përmirësim të aksesit turistik deri në breg. Komponenti synon të aktivizojë peizazhin ujor për rekreacion dhe turizëm natyror, duke respektuar kërkesat mjedisore, pronësore dhe teknike të Fazës II.



Shtigjet outdoor, pikat e pushimit dhe vrojtimit

Një tjetër komponent është krijimi i "View Point Podguri", me platformë panoramike, mobilim të përshtatshëm dhe lidhje me shteg këmbësor të markuar, si dhe zhvillimi i shtigjeve turistike për ecje në natyrë dhe kalërim drejt Majës së Podgurit. Përgjatë itinerareve parashikohen pika pushimi dhe vrojtimi panoramik, duke e integruar projektin me kategorinë e zhvillimit të destinacioneve të turizmit natyror dhe outdoor.



Muzeu "Kulla e Kurpalëve"

Muzeu "Kulla e Kurpalëve" trajtohet si nyja kryesore e interpretimit kulturor të projektit. Parashikohet modernizimi dhe digjitalizimi i përvojës së vizitorit përmes sistemeve audio-vizuale, ndriçimit ekspozues, materialeve digjitale informuese, pikës së informacionit dhe biletarisë, si dhe një strukture shërbimi. Ndërhyrjet do të koordinohen me institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe do të respektojnë dokumentacionin teknik e ligjor të kërkuar.



Sinergjia me investimet ekzistuese. Gjatë viteve të fundit Bashkia Has ka përfituar investime nga FSHZH dhe programe të tjera zhvillimore në zonë, përfshirë përmirësime të aksesit lokal, ndriçimit publik dhe infrastrukturës së mobilitetit. Projekti i propozuar synon t'i plotësojë këto ndërhyrje duke u dhënë atyre një funksion të qartë turistik dhe ekonomik.

Vlera e shtuar e projektit qëndron te integrimi dhe komplementariteti: trashëgimia kulturore, natyra, aktivitetet outdoor, pritja e vizitorit, interpretimi digjital dhe ekonomia lokale lidhen në një sistem të vetëm destinacioni. Kjo qasje i përgjigjet drejtpërdrejt kriterit të FSHZH-së për ndërhyrje të integruara që krijojnë sinergji dhe shmangin fragmentimin e investimeve.

Ndikimi social-ekonomik dhe rajonal. Hasi përballet me sfida të vazhdueshme demografike dhe ekonomike, veçanërisht emigrimin e të rinjve dhe bazën e kufizuar të punësimit. Projekti synon të rrisë vizitueshmërinë dhe kohëqëndrimin, të krijojë kërkesë për produkte e shërbime vendore dhe të forcojë lidhjet mes fshatrave, pikave turistike dhe operatorëve lokalë. Përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë përfshijnë komunitetin lokal, të rinjtë, artizanët, fermerët, bujtinat, guidat dhe sipërmarrjet e vogla të turizmit.

Qëndrueshmëria dhe funksionalizimi pas investimit. Projekti do të shoqërohet me model të qartë operimi, mirëmbajtjeje dhe promovimi nga Bashkia Has, në koordinim me institucionet përgjegjëse për asetet e veçanta. Bashkia do të sigurojë funksionalitetin e investimeve, monitorimin e rezultateve, raportimin e indikatorëve dhe burimet e nevojshme për mirëmbajtjen, në mënyrë që ndërhyrjet të mbeten aktive edhe pas përfundimit të financimit.

Roli dhe angazhimi i Bashkisë Has. Në përputhje me Udhëzuesin, Bashkia do të vërë në dispozicion asetet publike dhe dokumentacionin pronësor, teknik e ligjor; do të përgatisë dhe zhvillojë procedurat e prokurimit të deleguara nga FSHZH; do të monitorojë dhe supervizojë zbatimin; do të miratojë situacionet dhe raportimet; do të realizojë indikatorët e projektit; do të marrë në dorëzim investimin dhe do të garantojë operimin e mirëmbajtjen e tij në mënyrë të qëndrueshme.

Bashkëfinancimi dhe vendimmarrja e Këshillit Bashkiak

Sipas Udhëzuesit të skemës, FSHZH financon deri në 35,000,000 (tridhjetë e pesë milionë) lekë me TVSH për projekt. Njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të bashkëfinancojë minimumi 5% të kostos totale të projektit dhe, njëkohësisht, të mbulojë financiarisht të paktën një kontratë të plotë në kuadër të projektit, me kusht që kjo vlerë të jetë jo më e ulët se 5% e kostos totale. Vlera e bashkëfinancimit duhet të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak dhe përbën detyrim të Bashkisë në kuadër të projektit.

Për t'u plotësuar sipas preventivit përfundimtar të Fazës II:

- Vlera totale e projektit: 24.000.000 lekë pa TVSH.
- Financimi i kërkuar nga FSHZH: 24.000.000 lekë pa TVSH, brenda kufirit të përcaktuar nga skema.
- Bashkëfinancimi i Bashkisë Has: 1.200.000 lekë pa TVSH, jo më pak se 5% e kostos totale dhe i strukturuar për të mbuluar të paktën një kontratë të plotë.

Për sa më sipër, i propozohet Këshillit Bashkiak Has:

- Të miratojë projektin "Hasi – Destinacion i Integruar Turistik Ndërkufitar: Model për Menaxhimin, Digjitalizimin dhe Zhvillimin e Turizmit Kulturor, Natyror dhe Rural" dhe vijimin e tij në Fazën II të skemës së FSHZH-së.
- Të miratojë vlerën e bashkëfinancimit të Bashkisë Has sipas preventivit dhe strukturës përfundimtare të financimit të projektit.
- Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë dhe strukturat përgjegjëse për plotësimin e dokumentacionit të Fazës II dhe për ndjekjen e procedurave të nevojshme për nënshkrimin dhe zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Marrëveshjes së Investimit me FSHZH.
- Të konfirmojë angazhimin e Bashkisë për operimin, mirëmbajtjen, raportimin dhe qëndrueshmërinë e investimit pas përfundimit të projektit.

Miratimi nga Këshilli Bashkiak i projektit dhe i bashkëfinancimit përkatës përbën kusht për vijimin e procedurave të Fazës II me FSHZH, dokumentacioni i plotë i së cilës duhet të dorëzohet brenda datës 05.10.2026.

Zyra e Urbanistikes

Novruz BARDHOSHI

Përgjegjës Sektori